



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 653/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj kryesuese, Afijete Sada Gllgjani dhe Ferki Xhaferi anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Antigona Murati, duke vendosur lidhur me apelet e Dimal Basha, kandidat për deputet nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega Ferizaj paraqitur kundër vendimit me numër 860-2021 të datës 04.03.2021 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shpalljen e rezultatit përfundimtar, për shkak të bartjes së votave të kandidati tjetër, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës të datës 14.02.2021, në seancën e panelit të mbajtur me 06.03.2021, mori këtë:

### V E N D I M

**REFUZOHEN** të pabazuara apelet Anr.653/2021, dhe Anr.654/2021, të gjitha të datës 05.03.2021, të paraqitura nga Dimal Basha, kandidat për deputet nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega Ferizaj të paraqitura kundër vendimit me numër 860-2021 të datës 04.03.2021 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shpalljen e rezultatit përfundimtar, të datës 04.03.2021, me të cilën ka kërkuar rinumërim të votave në vendvotimet 2510D/01R, 2510D/02R, 2510D/03R, 2510D/05R, 2501X/04R, 2501X/08R, 2501Y/07R, 2505D/01R, 2505D/02D, 2509/01R, 2530D/01D, 2531D/02D.

### A r s y e t i m

Me datë 05.03.2021, kandidati për deputet nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) Dimal Basha ka paraqitur në PZAP apelet Anr.653/2021, dhe Anr.654/2021, të gjitha të datës 05.03.2021, me të cilën pretendon se në vendvotimet 2510D/01R, 2510D/02R, 2510D/03R, 2510D/05R, ka rezultuar se një kandidat ka pasur 50 vota më pak, ndërsa kandidati tjetër ka pasur 11 vota më pak, se ato që kanë qenë të shënuara në numërimin e parë. Më tutje thekson se në këto vendvotime disa kandidat tjerë siç është edhe ai kanë rezultuar me më shumë vota pas rinumërimit me të cilin iu është bërë njërit vendvotim. Në vendvotimet 2501X/04R, 2501X/08R, 2501Y/07R, 2505D/01R, 2505D/02D, 2509/01R, 2530D/01D, 2531D/02D, pretendon se nga formularët shihet qartë që votat e kandidatit me numër 38 iu janë shënuar vet kandidatit në fjalë Dimal Basha, me numër 39 ndërsa votat e tij iu janë shënuar kandidatit me numër 40, pastaj votat e kandidatit me numër 40 iu janë shënuar kandidatit me numër 41. Në vazhdim të apelit pretendon se në vendvotime tjera ka numër shumë më të ulët të votave në krahasim me distribuimin e votës normale për deri sa në këto vendvotime ka kandidat që nuk janë të zonës, por që janë të shënuar me numër të lartë të votave, gjë që është në shpërprthje me sasinë normale të votës së tyre që kanë marrë nëpër të gjitha vendvotimet tjera. Më tutje theksohet se në vendvotimin 2501x/04R, kandidatja Adriana Matoshi i ka 63 vota, që është shpërprthje me distribuimin e vendvotimeve tjera në atë shkollë, por edhe komunë, në vendvotimin 2501Y/07R pretendon se shpërndarja e votës nga kandidati numër 37 deri te kandidati numër 41 është e pazakonshme dhe secilit kandidat iu janë shënuar 20 deri 30 vota e që është absolutisht e pazakont dhe duhet të jetë një lëshim duke konsideruar që kandidatët nuk janë të njejtë qytet dhe ky trend nuk është asnjë VV tjetër në komunën e Ferizajit. Në vendvotimin 2530D/01D pretendon se kandidatja Bernarda Radoncic ka 76 vota me të cilën është numër shumë i lartë i votave duke konsideruar faktin se kandidatja nuk vie nga ky qytet dhe në asnjë vendvotim tjetër nuk ka kaq shumë vota dhe

i njejt i pretendon se në këtë kuti i ka 20 vota. Në VV 2531D/02D, pretendon se kandidatja Jeta Statovcika ka 42 vota me të cilën e njejt nuk ka distribuim të njejt të votës në këtë rajon dhe i njejt në këtë VV ka vetëm 9 vota. Kërkon nga paneli që ti aprovohet apeli dhe të urdhërohet KQZ të bëjë për rinumërimin e të gjitha kutive të lartshënuara.

Paneli, në bazë të nenit 13.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka bashkuar apelet e lartcekura dhe i trajton si një apel i evidentuar me Anr.653/2021, për shkak të natyrës së njejt të rasteve dhe pretendimeve që përmbajnë në vete çështje të ngjashme dhe se ato apele të trajtohen me një vendim i vendosi me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i shqyrtoj pretendimet ankimore dhe materialin zgjedhor e pas vlerësimit të gjithanshëm të tyre gjeti se:

#### **Apelet janë të pabazuara**

Paneli, vlerëson se parashtruesi i apeleve në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur mos përfshirje dhe bartje të votave të parashtruesit të apeleve gjatë shënimit të votave në formularin e kandidatëve numërimit të votave, për faktin se thëniet e tij nuk mbështetën në asnjë provë konkrete por janë të imagjinuara sepse pritjet e ankuesit për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mos përfshirje të saktë të rezultatit si dhe llogaritja matematikore nga ana e ankuesit nuk argumenton shkeljet e pretenduara në apel.

Andaj, Paneli vlerësoi se apelet e parashtruara nga Dimal Basha, i subjektit politik LVV, nuk janë bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë shënimit të votave apo bartje e gabueshme të votave në formularin e listës së kandidatëve për VV e cekura në apel.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Anr.653/2021 më datën 06.03.2021**

**Kryesuese e Panelit  
Kymete Kicaj**



***Këshilla Juridike:*** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimin të këtij vendimi.